



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	31.12.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-502

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Prizren, më 31.12.2018

Në mbështetje të nenit 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.12.2019, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Plani Strategjik i Universitetit "Ukshin Hoti" për periudhën 2020-2024.
- II. Plani Strategjik i Universitetit "Ukshin Hoti" për periudhën 2020-2024, do të rishikohet çdo vit, Këshilli Drejtues do të konsultohet me Ministrinë përkitazi me përputhjen e objektivave dhe të planeve të veta me Strategjinë shtetërore për arsimin e lartë dhe të burimeve që do të jenë në dispozicion nga Ministria.
- III. Pjesë përbërës e këtij vendimi do të jetë Plani Strategjik i Universitetit "Ukshin Hoti" për periudhën 2020-2024.
- IV. Pjesë përbërse e këtij vendimi do të jetë edhe Plani Financiar i Strategjisë 2020 - 2024.

A r s y e t i m

Plani Strategjik 2020-2024 i Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren është produkt i një procesi gjithpërfshirës të konsultimit me studentët, personelin akademik dhe administrativ, organet vendimarrëse, përfaqësuesit e biznesit, shoqërisë civile dhe pushtetin lokal.

Në këtë Plan strategjik janë dizajnuar objektivat institucionale afatmesme dhe afat gjata të Universitetit në përputhje me misionin dhe vizionin e rishikuar. Njëkohësisht, ky plan adreson rekomandimet e grupit të ekspertëve ndërkombëtar të angazhuar nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA). Ky Plan strategjik do t'i shërbej organeve drejtuese si udhërrëfyes për zbatimin e projekteve zhvillimore të Universitetit në funksion të përmbushjes së pritshmërive të komunitetit, studentëve dhe padagogëve për periudhën vijuese.

Prioritetet strategjike të këtij plani mëtojnë sigurimin e cilësisë në procesin e edukimit; zhvillimin e punës kërkimore-shkencore; bashkëpunimin dhe kontributin në komunitet; ndërkombëtarizimin dhe rrjetëzimin, zhvillimin e infrastrukturës dhe digjitalizimin, si dhe

qëndrueshmërinë financiare. Përmbushja e këtyre prioriteteve strategjike përbën një sfidë për institucionin tonë, por edhe një mundësi për të ndërtuar një qendër ekselence të edukimit dhe hulumtimit e cila i shërben shoqërisë.

Të bindur që projeksionet të këtij plani strategjik përbëjnë themelet e një storie të suksesit për rajonin e Prizrenit, Republikën e Kosovës dhe më gjerë, Këshilli Drejtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Dekanëve;
- MASHT-it
- Arkivit.

Prof. Asoc. Dr. Beqir Muhadri

Kryesues i Këshillit Drejtues

